



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE
PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 5838/2 prot.

Tiranë, më 30.10. 2020

Lënda: Mbi fillimin e vitit akademik 2020-2021

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.3, Tiranë

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 4, Tiranë

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e "Dibrës", Nr. 371, 1005, Tiranë

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Pajsi Vodica", Kodër Kamëz, Tiranë

UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, Tiranë

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollështa", Tiranë

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Sheshi "2 Prilli", nr. 24, Shkodër

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Adresa: Rruga "Ismail Zyma", Elbasan

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Adresa: Bulevardi "Rilindasit 1", Korçë

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastër

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS

Adresa: Rruga "Currila", 14, 2001, Durrës

AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

Adresa: Rruga "Odhise Paskali", Tiranë

AKADEMISË SË SIGURISË

Adresa: Rruga e "Elbasanit", Tiranë

UNIVERSITETIT "NEW YORK", TIRANË

Adresa: Rruga "Kodra e Diellit", Selitë, Tiranë

UNIVERSITETIT "LUARASI"

Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", 127/1, Tiranë

UNIVERSITETIT "ALBANIAN UNIVERSITY"

Adresa: Bulevardi "Zogu I", 1001, Tiranë

UNIVERSITETIT KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", Laprakë, Tiranë

AKADEMISË SË FILMIT DHE MULTIMEDIAS "MARUBI"

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 78, Tiranë

UNIVERSITETIT "BARLETI"

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", nr. 41, Tiranë

UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta" Nd. 70, H.1, Njësia Bashkiake Nr.7, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "WISDOM"

Adresa: Rruga "Medar Shtylla", Tiranë

UNIVERSITETIT "ALDENT"

Adresa: Rruga e "Dibrës", Tiranë

UNIVERSITETIT "POLIS"

Adresa: Rruga "Bylis 12", Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, SH2, Tiranë

UNIVERSITETIT "EPOKA"

Adresa: Autostrada Tiranë-Rinas, km. 12, Tiranë

**INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "SHKOLLA E LARTË
NEHEMIA"**

Adresa: Rruga "Nehemia", 7304, Buçimas, Pogradec

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", nr.52, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "PAVARËSIA", VLORË

Adresa: Bulevardi "Ismail Qemali", Vlorë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

Adresa: Pallati i Sportit "Asllan Rusi", Rr "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort, Tiranë

UNIVERSITETIT "METROPOLITAN TIRANA"

Adresa: Rruga "Pjetër Budi", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "TBU"

Adresa: Rruga "Vaçe Zela", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR"

Adresa: Kompleksi "Usluga", Rruga "Jordan Misja", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "REALD"

Adresa: Rruga "Zahir Pajaziti", Vlorë

KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT

Adresa: Rruga "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"

Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", Kompleksi "Xhura", nr.12, Tiranë

AKADEMISË "IVODENT"

Adresa: Rruga "Prokop Myzeqari", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"

Adresa: Rruga "Taulantët", Kodër-Kamëz, Tiranë

KOLEGJIT PROFESIONAL TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", Kompleksi "Xhura", Tiranë

KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË, "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Adresa: Rruga "Gjeneral Nikols", Pallati Shushica, kati 1, Tiranë

DEGËS: "EPITECH ALBANIA"

Adresa: Ndërtesa 07, Tirana Business Park - Rruga e Rinësisë, Tiranë

Në zbatim të pikës 7, të nenit 57 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 3 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, vlerëson punën përgatitore dhe të gjitha masat e marra deri më tani nga IAL-të në respektim të akteve rregullatore, lidhur me masat dhe protokollat higjieno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID-19.

Por ju bëjmë me dije se, në vijim të propozimit të datës 29.10.2020 të Komitetit Teknik të Ekspertëve, për zhvillimin e procesit mësimor vetëm në distancë dhe pa prezencë fizike për një muaj nga institucionet e arsimit të lartë, MASR me shkresë nr. 5838 prot., datë 30.10.2020 i kërkoj Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që për studentët që fillojnë për herë të parë një program studimi,

të lejohet prezenca e tyre në IAL, në grupe të vogla sipas një grafiku të përcaktuar, vetëm për javën e parë të vitit akademik 2020-2021, në përputhje me rregullat e distancimit fizik, si dhe masat e protokollit e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik dhe MSHMS-ja, me qëllim që këta studentë të njihen me rregullat e funksionimit të procesit mësimdhënës pranë IAL-ve ku do të ndjekin programin e studimit dhe të njihen me procedurat e zhvillimit të procesit mësimdhënës në distancë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 4859/1 prot., datë 30.10.2020, të cilën e gjeni bashkëlidhur, sqaron se lejimi i prezencës së studentëve që fillojnë për herë të parë një program studimi, sipas një grafiku të përcaktuar, vetëm për javën e parë të vitit akademik është i pamundur.

Duke mbajtur në konsideratë sa më lart, MASR si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e arsimit të lartë, në zbatim të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015, dhe në vijim të mirëadministrimit të procesit mësimdhënës, kërkon nga ana juaj, duke mos cenuar njëkohësisht lirinë akademike, autonominë financiare dhe organizative të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr. 80/2015, në kuadër të të gjitha masave të ndërmarra, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore që ju keni për fillimin e vitit akademik 2020-2021, procesi mësimdhënës, pavarësisht formës së mësimdhënies, të jetë i dokumentuar edhe në formë elektronike dhe të ketë mundësi kontrolli në çdo kohë për evidentimin e realizimit të tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Alqi KUSHI



MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
Nr. 5838/1 Prot.
Datë 30.10.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
ZËVENDËSMINISTËR

Nr. 4859/1 Prot.

Tiranë, më 30 / 10 / 2020

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 23, AL 1001, Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.5838 Prot, datë 30.10.2020, nëpërmjet së cilës kërkohet miratimi për lejimin e prezencës së studentëve që fillojnë për herë të parë një program studimi sipas një grafiku të përcaktuar vetëm për javën e parë të vitit akademik, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Komiteti teknik i ekspertëve në mbledhjen e datës 29.10.2020 zhvilloi një diskutim të gjërë deri në arritjen e përfundimit që mësimdhënia në universitete të paktën muajin e parë të zhvillohet pa prezencë fizike vetëm në distancë.

Gjatë këtyre diskutimeve u analizua me kujdes situata epidemiologjike në vend dhe u konstatua që vendet ku janë të përqëndruara IAL-të janë vatra të larta infektimi duke filluar nga Tirana, Durrësi etj. Epidemiologët në Komitet argumentuan që ardhja nëpër auditoret e IAL-ve apo edhe në konviktet ku akomodohen studentët nga i gjithë vendi do të përbënte shkas për përhapjen e infeksionit Covid-19 edhe në ato zona ku situata epidemiologjike është më e ulët. Sigurisht, Komiteti e diskutoi edhe mundësinë e fillimit të vitit të ri shkollor për studentët që hynë për herë të parë në universitet nisur nga fakti që pjesë e komitetit janë edhe pedagogë të IAL-ve, por epidemiologët argumentuan se në kushtet që jemi edhe një alternativë e tillë paraqet rrezikshmëri në përhapjen e infeksionit Covid-19.

Përsa më sipër, Komiteti Teknik i Ekspertëve gjykon që lejimi i prezencës së studentëve që fillojnë për herë të parë një program studimi sipas një grafiku të përcaktuar vetëm për javën e parë të vitit akademik është i pamundur.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

ZËVENDËSMINISTËR

Mira Rakacolli

